



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 4: Statistikat e Llogarive Kombëtare

Llogaritë Qeveritare të Kosovës TM4 2018



P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht Departamenti i Llogarive Kombëtare ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës për TM4 2018. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ASK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit, për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: economic@rks-gov.net.

Ky publikim është përgatitur nga:

Fatmir Morina - Drejtor i Departamentit

Edona Rexhepaj– Udhëheqëse e Divizionit

Vjosa Prekazi- zyrtare e lartë

Ilir Mazrekaj – zyrtar i lartë.

Prishtinë, Mars 2018

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Lista e Shkurtesave

BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
ESA	-	Llogaritë e Sistemit Evropian (European System of Accounts)
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MF	-	Ministria e Financave
TKPK	-	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
AKP	-	Agjencia Kosovare e Privatizimit
:	-	Mungojnë të dhënat
_	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

Faqe

1.Hyrje.....	4
2.Të hyrat - Qeveria e përgjithshme.....	5
Tabela 1: Struktura e të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme bazuar ne ESA2010	5
Grafiku 1. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme bazuar në ESA2010.....	6
3.Shpenzimet – Qeveria e përgjithshme	7
Tabela 2. Shpenzimet Qeveria e Përgjithshme bazuar ne ESA2010	7
Grafiku 2.Shpenzimet Qeveria e përgjithshme bazuar në ESA2010	8
Tabela 3. Shpenzimet Qeveritare ne baze te COFOG	9
Grafiku 3.Shpenzimet Qeveritare në baze të COFOG	10

1. Hyrje

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën TM4 2018, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së.

Si rregull i përgjithshëm ka për qëllim pajtueshmërinë maksimale të shifrave të publikuara me standardet e ESA 2010 dhe manualin e FMN-së për statistikat e Financave Qeveritare.

Burimet e të dhënave janë: Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit .

2. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme

Shuma e të hyrave të Qeverisë së përgjithshme për TM4 2018 ishte 500.7 milion Euro.

Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte të cilat paraqesin 71% të totalit të të hyrave , ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.

Tabela 1: Struktura e të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010

(në milion Euro)


ESA2010	Përshkrimi	TM4_2016	TM1_2017	TM2_2017	TM3_2017	TM4_2017	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018
D21	Tatimet në produkte	319.6	247.2	317.6	377.9	357.2	258.7	335.0	394.3	353.3
D211	Tatimi mbi vlerën e shtuar(TVSH)	175.1	135.8	175.3	202.1	199.0	149.3	188.9	217.3	203.4
D212	Tatimi dhe dogana ne importe duke perjashtuar TVSH	136.1	103.0	133.2	166.1	149.0	100.8	137.1	167.1	140.7
D2121	Detyrimet e importit	33.4	23.8	32.2	34.3	36.2	24.9	32.3	34.6	38.4
D2122	Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet	102.7	79.2	101.0	131.7	112.8	75.9	104.9	132.5	102.2
D214	Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	8.3	8.4	9.0	9.8	9.3	8.5	9.0	10.1	9.3
D29	Tatimet tjera në prodhim	12.2	13.2	12.0	11.0	10.1	10.0	10.1	10.1	9.8
D4	Të hyrat nga prona	3.3	8.2	-	-	1.2	-	6.5	-	6.5
D5	Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	53.4	55.7	61.4	60.0	56.0	70.7	68.7	62.4	69.7
D7	Transfertat e tjera aktuale	9.8	4.3	5.0	7.0	5.7	4.4	6.3	7.2	7.9
F	Aktivët dhe detyrimet financiare * **	15.8	103.2	31.2	31.6	46.0	39.0	11.9	133.8	23.4
P131	Pagesat për output jo-tregut (Shitjet)	22.4	27.1	21.6	23.0	26.9	25.8	22.4	28.1	30.1
Gjithsej		436.6	458.9	448.7	510.5	503.1	408.5	461.0	635.9	500.7

* Përfshirë: Depozitat, letrat me vlerë , huatë etj

** Përfshirë fondet e likuidimit nga AKP në TM3 2018

Struktura e të hyrave të Qeverisë së përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1:

Grafiku 1. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme bazuar në ESA2010



3. Shpenzimet – Qeveria e përgjithshme

Në TM4 2018 totali i shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme ishte 648.2 milion Euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë formimi i kapitalit bruto 33%, kompensimi i punëtorëve me pjesëmarrje 24%, kontributet sociale dhe përfitimet 21%, konsumi i ndërmjetëm me pjesëmarrje prej 12%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në struktura tjera të shpenzimeve.

Tabela 2. Shpenzimet Qeveria e Përgjithshme bazuar në ESA2010


(në milion Euro)

ESA2010	Përshkrimi	TM4_2016	TM1_2017	TM2_2017	TM3_2017	TM4_2017	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018
D1	Kompensimi i punëtorëve	136.9	136.8	137.7	136.0	140.2	143.8	149.7	145.6	152.8
D3	Subvencionet	32.7	16.0	23.9	28.0	33.1	19.8	16.4	36.8	34.7
D4	Të ardhurat nga prona, të pagueshme	2.5	7.1	3.0	5.3	3.2	6.0	3.3	6.1	3.4
D6	Kontributet sociale dhe përfitimet	111.3	94.0	106.5	94.6	125.7	111.3	117.0	120.0	133.4
D7	Transferrat e tjera aktuale	5.0	0.1	0.3	2.2	5.9	7.8	0.2	7.0	8.4
D9	Transferrat kapitale	21.7	4.1	4.0	2.5	10.9	2.7	1.8	2.6	13.5
F	Aktivitet dhe detyrimet financiare*	16.2	18.3	16.1	17.1	8.9	5.8	3.3	6.4	7.4
NP	Posedimi i aktiveve jo-prodhuese	6.8	0.8	2.4	1.8	2.0	0.4	1.1	1.1	4.0
P2	Konsumi i ndërmjetëm	75.9	36.1	44.9	36.9	74.0	40.8	46.8	43.8	78.0
P5	Formimi i kapitalit bruto	187.4	54.8	100.0	117.4	183.4	74.9	95.8	105.2	212.8
Gjithsej		596.4	368.0	439.0	441.9	587.3	413.5	441.8	474.5	648.2

* Përfshirë: Depozitat, letrat me vlerë, huatë etj

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 2:

Grafiku 2. Shpenzimet Qeveria e përgjithshme bazuar në ESA2010



Në TM4 2018 shuma e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme ishte 648.2 milion Euro.

Shpërndarja më e madhe e shpenzimeve është bërë në sektorin: çështjet ekonomike me pjesëmarrje prej 26%, mbrojtja sociale 17%, arsimi 15%, shërbime të përgjithshme me pjesëmarrje prej 13%, shëndetësia 10% ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në sektorët e tjerë.

Tabela 3. Shpenzimet Qeveritare ne baze te COFOG


(në milion Euro)

Përshkrimi	TM4_2016	TM1_2017	TM2_2017	TM3_2017	TM4_2017	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018
Shërbimet e përgjithshme*	55.3	58.8	64.5	64.5	82.8	48.0	52.6	59.7	85.2
Mbrojtja	19.7	6.7	8.0	8.9	11.4	8.4	9.9	8.3	20.0
Rendi dhe siguria publike	44.5	32.5	39.8	35.6	48.2	37.7	43.9	41.2	53.6
Çështjet Ekonomike	195.0	66.4	92.1	111.7	148.7	87.6	87.0	107.9	168.3
Mbrojtja e Mjedisit	6.6	0.6	1.5	3.2	4.7	0.8	2.9	6.2	6.5
Strehim dhe pajisje për Komunitetin	15.6	4.0	8.2	8.8	14.3	4.8	7.9	8.2	22.4
Shëndetësia	50.6	39.0	44.4	38.9	56.3	42.1	45.6	47.2	64.8
Rekreacioni, kultura dhe Religjioni	12.3	8.2	12.8	10.4	16.6	12.9	10.5	16.0	17.7
Arsimi	87.3	60.6	68.7	68.3	85.1	64.4	70.7	69.3	97.5
Mbrojtja sociale	109.7	91.4	99.0	91.6	119.4	106.8	110.9	110.7	112.1
Gjithsej	596.4	368.0	439.0	441.9	587.3	413.5	441.8	474.5	648

* Përfshirë: Depozitat, letrat me vlerë, huatë etj

Shpërndarja e shpenzimeve sipas sektorëve (në përqindje) është paraqitur në grafikun 3.

Grafiku 3. Shpenzimet Qeveritare në baze të COFOG



Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>